



Për: Mediat e shkruara dhe elektronike
Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim
Subjekti: Vizitë e z. Pacollit në Republikën e Bullgarisë

Prishtinë, 12 Mars 2008

Njoftim

Kryetari i Aleancës Kosova e Re, z. Behgjet Pacolli, me ftesë të zv/ Presidentit bullgar, z. Angel Martin, do qëndroj sot në Bullgari.

Z. Behgjet Pacolli do të takohet fillimisht me Ministrin e Jashtëm të Republikës së Bullgarisë, z. Iavilo Kalfin, ku do të diskutojnë rreth procesit të njohjes sa më të shpejt të Pavarësisë së Kosovës nga ana e Bullgarisë. Gjithashtu do të diskutohet dhe për marrëdhëniet diplomatike në mes të këtyre dy shteteve.

Lideri i AKR-së, z. Behgjet Pacolli do të takohet edhe me zv/Presidentin Bullgar për të diskutuar, ndër të tjera, edhe për zgjerimin e aktiviteteve dhe bashkëpunimit në të gjitha sferat ndërmjet Kosovës dhe Bullgarisë.

Këto takime janë vazhdimësi e përkushtimit të z. Behgjet Pacolli për të përshpejtuar njohjen e Pavarësisë së Kosovës dhe procesin e integritit të Kosovës si Shtet i Pavarur dhe Sovran.

Agjenda

- 12.03.2008 - 11:00 Takim me Ministrin e Jashtëm të Republikës së Bullgarisë, z. Iavilo Kalfin.**

- 12.03.2008 - 15:00 Takim me zv/Presidentin Bullgar, z. Angel Martin**

**Arbër Geci
Zëdhënës i AKR-së**